



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORCË

VENDIM

Nr. 84 ,Datë 25 / 11 / 2011

PËR

**NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË MATERIALEVE TË INVENTARIT EKONOMIK
DHE ATIJ TE IMET DHE PER KALIM INVENTARI**

Këshilli i Bashkisë së Qytetit Korçë, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim materialin e pergatitur nga Ndermarrja e Sherbimeve Mbeshtetese e Arsimit dhe Cerdhes (dega e Financës) për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit ekonomik dhe atij të imët dhe propozimin për kalimin e një pjese të inventarit të shkolles “Sotir Gurra “ ne shkollat nentevjecare te disa komunave ,

në zbatim të Ligjit nr.8652,datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32 pika “e”, Ligjin nr.6942 datë 25.12.1984 “Per administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, të ndryshuar me Ligjin nr. 7426,datë 14.11.1990, V.K.M nr.70,datë 11.03.1985 ” Për administrimin,ruajtjen,dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”,të ndryshuar me V.K.M Nr.170, date 03.04.1993, si dhe mbas diskutimeve të Këshilltarëve ,

VENDOSI:

1. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve sipas llogaritjeve të mëposhtme:
 - a. Inventar ekonomik 6204683 (gjashtemeleondyqindekatermijegjashteqindtetedhjetetre) lekë.
 - b. Inventar i imët 952231 (nenteqindpesedhjetedymijedyqindetridhjetenje) lekë.
2. Materialet të cilat do të nxirren jashtë përdorimit janë të pasqyruara në procesverbalet bashkangjitur këtij vendimi.
3. Te miratoje kalimin e nje pjese te inventarit nga shkolla 9-vjecare Sotir Gurra ne shkollat 9-vjecare Pirc, Barc,Sovjan ,Moglice,Vreshtas .

4 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndermarja Sherbimeve Mbeshtetese te Arsimit dhe Cerdhes.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ILIRJAN PENDAVINJI



Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org